



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me banor të fshatrave: Reqan, Struzhë, Pouskë, Jabllanicë, Llokvicë, Manasterice, Nebregosht, Zhivinjanë, Pllaniane, Bogoshefc, Mushnikovë, Sreckë, Gornje Sello, Prevallë ,Lubinje e Poshtme, Lubinje e Epërme dhe
Drajqiç**

Me datë: 10.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/1-Njoftim-per-degjim-buxhetor-me-banor-te-Rajonit-te-Zhupes-Reqan.pdf>

Me 10.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-banoret-e-fshatrave-te-rajonit-te-zhupes-per-organizimin-e-degjimit-buxhetor-per-pergatitjen-e-buxhetit-te-vitit-2025/>

Me 13.07.2024, është publikuar projekt buxheti për vitin 2025/2027 për rajonin e Zhupës:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-per-rajonin-e-Zhupes-2025-2027.pdf>

Procesverbali:

Dëgjimi me banor të rajonit të Zhupës gjegjësisht fshatrave: Reqan, Struzhë, Pouskë, Jabllanicë, Llokvicë, Manasterice, Nebregosht, Zhiviniane, Pllaniane, Bogoshefc, Mushnikovë, Sreckë, Gornje Sello, Prevallë ,Lubinje e Poshtme, Lubinje e Epërme dhe Drajqiç i mbajtur me datë 18.07.2024.

Dëgjimi ka filluar në orën: 18:40

Hapja e takimit është bërë nga Ymer Berisha, udhëheqësi i njësisë për Komunikim me Publikun i cili ka thënë se kemi kënaqësinë që jemi sëbashku me ju, kryetarin Shaqir Totaj ka kërkuar që ta hapim politikën më të madhe publike, pra buxhetin për vitin 2025. Ju njoftoj se njoftimet janë bërë me kohë në gjuhët zyrtare, janë publikuar në webfaqe, rrjetin social të komunës gjithashtu njoftimi është dërguar edhe tek kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve. Zyrtarët përgjegjës, do të mbajnë shënime, dhe do të përgatisin procesverbal dhe raport të njëjtë më pas do të publikohen në webfawen zyrtare. Për këtë vit është planifikuar të mbahen 11 dëgjime buxhetore, kërkesat Ju mund ti dërgoni edhe përmes emailave zyrtar, kërkesat tuaja do të trajtohen dhe do të merrni përgjigje për secilën kërkesë.

Kryetari, Shaqir Totaj, ka thënë se jemi këtu që ti marrim kërkesat apo nevojat që ju i keni, e di që të gjitha kërkesat nuk do të mund ti fusim në buxhet por ju kërkesat ti bëni duke u bazuar në prioritetet që ju i keni, dhe më pas ne sipas mundësive buxhetore kërkesat tuaja ti fusim në buxhet. Ne kemi investuar këtu, por që sigurisht që do të vazhdojmë edhe më tutje.

Sulltan Badalli, drejtor për Buxhet dhe Financa i cili ka prezantuar buxhetin e paraparë për vitin 2025, buxhetin të cilin ju mund ta shihni përmes video projektorit është i hartuar duke u bazuar në qarkoren e ministrisë së financave, pra ministria përmes qarkores na i ka caktuar tavanet buxhetore, buxheti për vitin 2025 është : Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0

Kërkesat e qytetarëve:

- Bashkim Bajrami-Rehabilitimi i rrugës prej Sredskës deri në Drajçiç.
- Amir Bajrami-Të ketë kujdestari nga zjarrëfikësit,
Përfundimi i aneksësit të ambulancës,
Largimi i rampës në rrugën Prizren-Prevallë,
Rregullimi i rrugës Reqan Lubinjë.
- Bashkim Bajrami-Kubëzimi i rrugëve brenda fshatit Drajçiç.
- Ismet Rustemoviç-Zgjidhja për zyret lokale dhe dhënja e vulës.
- Halit Karadollami-Shtrimi me asfalt i 100 m² rrugës ne hyrje të fshatit Lubinje e Poshtme.

Dëgjimi ka përfunduar në orën: 18:40

Raportet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore mund ti gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/raportet-degjimet-publike/> .

Projekt buxhetin për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, mund ti gjeni ne këtë vegez: <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/projekt-buxheti/> .

Lajmi për mbajtjen e dëgjimit publik: <https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-e-prizrenit-organizon-11-degjime-per-buxhetin-e-vitit-2025/> .

Procesmbajtës:

Gjafer Ponik

Haziz Krasniqi